

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR 2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHKURT 2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MARS 2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	05.03.2026	Kërkesë për informacion nga Televizion Kombëtar lidhur me shfrytëzimin e lumenjve për inerte.	13.03.2026	Referuar Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“, i ndryshuar, Televizionit Kombëtar iu ofrua informacion mbi hapat e ndërmarra për koordinimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe inspektimin e territorit.	E plotë	Pa tarife
2	09.03.2026	Kërkesë nga Kryetari i Fshatit Gjormë, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin për pastrimin e kanalit i cili ka sjell	10.03.2026	Referuar Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“, i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”,	E deleguar	Pa tarife

		përmbytje në rreth 60 ha tokë.		Prefekti i është drejtuar Bashkisë Kurbin dhe Drejtorisë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit Lezhë për rakordimin e punës dhe percaktimin e përgjegjësisë për secilin institucion në lidhje me ankesën e kryetarit të Fshatit Gjorm. Të informohet Prefekti i Qarkut Lezhë për masa a marra dhe afatet kohore për fillim e punimeve për pastrimin e kanalit.		
--	--	--------------------------------	--	---	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL 2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
3	19.3.2026	Ankesë e banorëve të një pallati në Njësinë Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, për largimin e mbetjeve inerte, trajtimin e ujërave të ndotur dhe rehabilitimin e zones pas prishjes së një ndërtimi pa leje në hapësirën publike përpara pallatit.	27.3.26	Referuar Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9780/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundraligjshme” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Prefekti i është drejtuar Bashkisë Lezhë dhe I.K.M.T Drejtoria Rajonale Lezhë si autoritete përgjegjëse të trajtojnë ankesën e banorëve dhe të vihet në dijeni Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë mbi hapat e ndërmarrë.	E deleguar	Pa tarife
4	25.3.26	Ankesë e një banori në Lagjen nr.6 , Bashkia Kurbin, për moszgjidhe të problematikës nga Bashkia Kurbin për përmbytjen e tokës dhe banesave të tija nga bllokimi i kanalit kullues.	27.3.26	Referuar Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, Prefekti i është drejtuar Bashkisë Kurbin si autoritet përgjegjës të trajtojë ankesën e banorit dhe të vihet në dijeni zyrtarisht Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë brenda afateve ligjore.	E deleguar	Pa tarife

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MAJ 2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
-------------------------	------------------------------	---------------------------------	--------------------------------	------------------------	---	---------------------

5	16.4.2026	Ankesë e paraqitur nga banorët e një pallati në Bashkinë Kurbin, lidhur me shkelje të standardeve teknike dhe procedurale gjatë punimeve të rikonstruksionit të objektit.	20.4.26	Referuar Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Prefekti i është drejtuar Bashkisë Kurbin, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, për të trajtuar ankesën e banorëve dhe për të vënë në dijeni Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë mbi hapat e ndërmarrë.	E deleguar	Pa tarife
6	08.5.26	Kërkesë nga institucion fetar në Bashkinë Kurbin për anulimin/pezullimin e lejes zhvillimore të projektin qe prek objektin fetar.	12.5.26	Referuar Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, objekti i kërkesës nuk është në fushën e përgjegjësisë së institucionit të prefektit.	E plotë	Pa tarife

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE QERSHOR 2026

Nr. Rendor ⁸	Data e kërkesës ⁹	Objekti i kërkesës ¹⁰	Data e përgjigjes ¹¹	Përgjigje ¹²	Mënyra e përfundimit të kërkesës ¹³	Tarifa ¹⁴
7	5.5.2026	Kërkesë në adresën email, për vendosjen e masave kufizuese të shpejtësisë në aksin rrugor Balldren–Torovicë e paraqitur nga banor të zones së Balldrenit.	20.5.26	Prefekti, me datë 15.05.2026, i është drejtuar me e-mail Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), në cilësinë e autoritetit përgjegjës, për trajtimin e ankesës së banorëve dhe për informimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë mbi hapat e ndërmarrë. Në datën 20.05.2026, ARRSH ka informuar se kontraktori i mirëmbajtjes së këtij aksi kombëtar ka marrë masat për vendosjen e sinjalistikës.	E plotë	Pa tarife
8	20.5.2026	Kërkesë nga banorë të fshatit Gjorm drejtuar Bashkisë Kurbin për furnizimin me ujë të pijshëm të shkollës së fshatit.	25.5.26	Referuar Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, i jemi drejtuar Bashkisë Kurbin për verifikimin e	E deleguar	Pa tarife

				problematikës së konstatuar dhe ndërmarrjen e masave përkatëse, në bashkëpunim me Shogërinë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve Lezhë.		
9	25.5.2026	Kërkesë nga banor i fshatit Balldre, Bashkia Lezhë për vënie në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të mbledhjes së Kësillit të Komunës Balldre për miratimin e ndërtimit të murit rrethues të Komunës Balldre.	29.5.2026	Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë i ka përcjellë me shkresë zyrtare kërkesit kopjen e dokumentacionit përkatës	E plotë	Pa tarife

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK 2026

Nr. Rendor ¹⁵	Data e kërkesës ¹⁶	Objekti i kërkesës ¹⁷	Data e përgjigjes ¹⁸	Përgjigje ¹⁹	Mënyra e përfundimit të kërkesës ²⁰	Tarifa ²¹
10	15.6.2026	Kërkesë nga banorët të Njësisë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, për ndërhyrje dhe marrjen e masave të nevojshme për lirin e hapësirave publike pranë pallatit, të cilat aktualisht janë të zëna apo të penguara në mënyrë që cenojnë lëvizjen e lirë të banorëve.	17.6.26	Prefekti i Qarkut Lezhë, me shkresën e datës 17.06.2026, i është drejtuar Bashkisë Mirditë duke kërkuar marrjen e masave për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës së ngritur nga banorët e pallatit, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e saj ligjore. Njëkohësisht, është kërkuar që Prefektura të vihet në dijeni mbi masat e marra dhe zgjidhjen e dhënë për këtë çështje.	E deleguar	Pa tarife
11	29.6.2026	Banorët e një pallati në Njësinë Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, kanë paraqitur në mënyrë të përsëritur shqetësimin e tyre lidhur me mosrealizimin e plotë të ndërhyrjeve të kërkuara për rehabilitimin e	6.7.26	Referuar Ligjit nr. 107/2016 ‘Për Prefektin e Qarkut’, të ndryshuar, dhe Ligjit nr. 139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’, të ndryshuar, Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar Bashkisë Lezhë për verifikimin dhe trajtimin e problematikës së ngritur nga banorët e pallatit, si dhe për marrjen e masave	E deleguar	Pa tarife

		hapësirës publike në pjesën përpara objektit të banimit. Sipas tyre, pavarësisht trajtimit paraprak të ankesës nga institucionet përgjegjëse, problematika vijon të mbetet e pazgjidhur në tërësinë e saj, duke ndikuar në kushtet e jetesës dhe përdorimin normal të hapësirës nga banorët.		konkrete dhe ushtrimin e kompetencave përkatëse brenda fushës së përgjegjësisë së saj.		
--	--	--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE GUSHT 2026

Nr. Rendor ²²	Data e kërkesës ²³	Objekti i kërkesës ²⁴	Data e përgjigjes ²⁵	Përgjigje ²⁶	Mënyra e përfundimit të kërkesës ²⁷	Tarifa ²⁸
12	23.7.2026	Kërkesë në adresën email, Banore e Qytetit të Tiranës. Numrin e lejeve të lëshuara për përdorimin e burimeve ujore, për lumin Mat që ndodhet në juridiksionin e Qarkut Lezhë për periudhën 2015-2026.	29.7.26	Prefekti i Qarkut Lezhë i kthen përgjigje kërkuarës, duke sqaruar se informacioni për lejet e shfrytëzimit të burimeve ujore duhet kërkuar pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Lumor Erzen-Ishëm-Mat. Gjithashtu informon se për parandalimin e marrjes së paligjshme të inerteve në lumenjtë Mat dhe Fan janë ndërmarrë kontrolle nga institucionet përgjegjëse, ku janë vendosur 15 masa administrative, janë sekuestruar mjete dhe janë referuar 9 raste në Prokurori.	E plotë	Pa tarife

13	24.7.2026	Një grup turistësh paraqiti ankesë ndaj një Restoranti në Shëngjin për cilësi të dobët të ushqimit, mospërputhje të pjatave me përshkrimin në menu dhe informacion kontradiktor nga stafi.	7.8.2026	Prefekti i Qarkut Lezhë iu drejtua Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Lezhë për trajtimin e ankesës së paraqitur ndaj një restoranti në Shëngjin. Pas verifikimeve të kryera, AKU Lezhë konstatoi se aktiviteti zhvillohej në kushte të rregullta higjieno-sanitare, pa evidentuar shkelje që cenonjë sigurinë ushqimore të konsumatorëve. Gjatë kontrollit u konstatua vetëm një mangësi e vogël në ambientin e kuzhinës, për të cilën u mor masa administrative “Paralajmërim”.	E plotë	Pa tarife
----	-----------	--	----------	---	---------	-----------

¹Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar /E refuzuar / E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

Regjistri përmban të përditësuar kërkesat dhe ankesat për periudhën në datat 1 Janar 2026 – 17 Gusht 2026, ku janë paraqitur në total 13 kërkesa të protokolluara në adresën e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë.